



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:173968

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05355832

C.nr.1590/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.D.Sh. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. E.G. nga Prizreni, kundër të paditurve: S.D.1., S.D.2., R.D.1., R.D.2., dhe A.D. që të gjithë nga fshati Komuna e Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë, vlera e kontestit 100.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia C.nr.1590/2021 e datës 05.08.2021, e paditëses F.D.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurve: S.D.1., S.D.2., R.D.1., R.D.2., dhe A.D. që të gjithë nga fshati Komuna e Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë.

A r s y e t i m

Paditësja F.D.Sh. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. E.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurve: S.D.1., S.D.2., R.D.1., R.D.2., dhe A.D. që të gjithë nga fshati Komuna e Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të trashëgimisë, vlera e kontestit 100.00 euro.

Me aktvendimin C.nr.1590/2021 e datës 22.12.2023, gjykata ka ftuar paditëses, përkatësisht të autorizuarin e saj që gjykatës t'i dorëzoj padinë dhe provat në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, përkatësisht padinë dhe provat edhe në (3) një kopje tjera, për palën e paditur, brenda afatit prej 3 (tre) ditësh nga pranimi i aktvendimit, me paralajmërimin e pasojave që nëse nuk vepron sipas detyrimit dhe afatit të përcaktuar në pikën nën I. të aktvendimit C.nr.1590/2021 e datës 22.12.2023, padia do të hedhet poshtë.

Aktvendimin e lartcekur, i autorizuari i paditëses e ka pranuar më datë 28.12.2023, fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa e gjykatës e datës 26.12.2023, ndërsa deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi, pala paditëse nuk ka vepruar sipas aktvendimit C.nr.1590/2021 e datës 22.12.2023.

Në këtë drejtim, gjykata ka ardhur në përfundim se padia e paditësit duhet të hedhet poshtë, në përputhje me nenin 102 par. 4 të LPK-së, pasi që paditësja nuk kanë vepruar sipas urdhrit të dhënë në aktvendimin C.nr.1590/2021 e datës 22.12.2023.

Kështu, në nenin 102 par. 4 të LPK-së thuhet që “në qoftë se parashtruesat apo dokumentet që i bashkëngjiten nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë parashtruesin që brenda afatit të caktuar t'i paraqes ato. Po që se parashtruesi nuk vepron sipas këtij urdhri, gjykata do ta hedhë poshtë parashtruesën e tij”. Në anën tjetër, me aktvendimin C.nr.1590/2021 e datës 22.12.2023, pala paditëse në mënyrë të qartë dhe konkrete është

udhëzuar për plotësimet dhe korrigjimet të cilat duhet të bëhen lidhur me padinë C.nr.1590/2021 e datës 05.08.2021, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar konform këtyre paralajmërimeve, përkatësisht urdhrave.

Në këtë drejtim, gjykata vë në dukje faktin se është pala paditëse që duhet t'i ofroj gjykatës padinë dhe provat përcjellëse në kopje të mjaftueshme, të cilën gjë pala paditëse ka dështuar ta bëjë.

Andaj, pasi që në përputhje me nenin 171 par. 1 të LPK-së gjykata është e lidhur me aktvendimet e saj, vendosi që padia e paditësit të hedhet poshtë.

Nga se u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 102 par. 4 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1590/2021 të datës 21.02.2024

Gj y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.